



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 426 / prot. 12

Tiranë, më 15.04.2024

N J O F T I M

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006, “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, Urdhrit të Kryeministrit nr. 140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së TKOBAP-së”, Statutit të TKOBAP të miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funkcionimin e TKOBAP-së”, **shpall audicionin për pozicionin e punës “Pianist Korepetitor” pranë Drejtorisë së Baletit.**

Për t’i dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhojë për t’i krijuar mundësi pjesëmarrjes më të madhe në numër të konkurrentëve, TKOBAP nxjerr njoftimin e saj ditën e sotme.

Audicioni do të zhvillohet në **datën 15.05.2024, ora 10:00, në Sallën e baletit të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor.**

-Kandidati duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar ose i huaj;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën e provuar me dokumentacionin përkatës;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje të certifikuar nga shteti i tij;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.
7. Të ketë njohuri minimalisht të 2 gjuhëve të huaja, të detyrueshme anglisht dhe italisht.

Të gjithë artistët e interesuar për pjesëmarrje në këtë audicion, duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së TKOBAP-së deri në datën 8.5.2024, ora 16:30:

1. Një letër shprehje interesi për vendin vakant;
2. Fotokopje e dokumentit të identitetit të vlefshëm;

3. Vërtetim të gjendjes shëndetësore ose një dokument ekuivalent me të;
4. Vërtetim të gjendjes gjyqësore ose një dokument ekuivalent me të;
5. Fotokopje të diplomës dhe listë notash të noterizuar në shtetin përkatës (të ketë kryer ose të jetë në përfundim të studimeve të larta në nivelin Master për piano brenda ose jashtë vendit);
6. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) ose një dokument ekuivalent me të;
7. Jetëshkrim (Curriculum Vitae) bashkëngjitur me foto dhe dokumentacionin e nevojshëm që vërteton: veprimtarinë ndër vite të certifikuar, Master class-e, Work shop-e, programe koncertesh, recitalesh, shfaqje të ndryshme, tituj artistikë si dhe të dhëna të tjera që plotësojnë figurën e tij artistike për vendin vakant për të cilin aplikon.

Programi:

***Programi për konkurimin është interpretimi (përzgjedhja për interpretimin nga kandidatët do të bëhet nga Komisioni i Vlerësimit) nga veprat e mëposhtme:**

1. Baleti "Arrëthyesi", Akti 2
2. Baleti "Liqeni i Mjellmave", Akti 3
3. Opera "Aida", numrat koreografike në "Gran Finale Secondo"
4. Një pjesë pianistike solistike deri në 10 min.
5. Shoqërim i ushtrimeve të baletit të kërkuara nga komisioni.
6. Provë e kulturës së përgjithshme në lidhje me literaturën koreografike në përgjithësi dhe veprat që janë subjekt i audicionit në veçanti.

Shënim:

-Komisioni ruan të drejtën të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit

Për sqarime të mëtejshme, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni në adresën elektronike:
sekretaria@tkob.gov.al.

DREJTORE E PËRGJITHSHME

Abigeila Voshtina